



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 12 par. 12.1, dhe 17 pika r) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008 , dhe neneve 9 pika r) , 20 par 20.1, dhe 51 pika b) dhe pika dh) të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 15.09.2023, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës mori këtë:

VENDIM
PËR PËRCAKTIMIN E FESTIVALIT “RINIA FEST - LIPJAN” SI FESTIVAL
TRADICIONAL I KOMUNËS SË LIPJANIT

I.Me këtë Vendim përcaktohet që festivali “Rinia Fest - Lipjan ”, të jetë festival tradicional i Komunës së Lipjanit.

II. Festivali tradicional “Rinia Fest - Lipjan ”do të mbahet çdo vit me datën 12 gusht , për nder të Ditës ndërkombëtare të rinisë 12 gushtit dhe mund të zgjasë edhe më shumë se një (1) ditë varësisht nga agjenda e planifikuar për secilin vit përkatës.

III. Për organizimin dhe mbajtjen e këtij Festivali do të kujdeset Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport i Komunës së Lipjanit.

IV.Mjetet financiare për organizimin dhe mbajtjen e këtij Festivali do të sigurohen nga buxheti i Komunës.

V. Ky Vendim hynë në fuqi 7 ditë pas publikimit në Faqen Zyrtare të Komunës

Nr. 15-644/01-53385

Lipjan, më 15.09.2023

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi

